



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu
Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 1/212

Datë: 21 / 4 / 2026

Në bazë të kompetencave të përcaktuara në nenin 20, paragrafi 2, nënparagrafët 2.1, 2.2 dhe 2.4, si dhe në zbatim të neneve 65, 66, 67, 68, 69 dhe 70 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, me numër të protokollit KUV-08-V-770-ST, Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 01.04.2026, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR STUDIMET THEMELORE – BAÇELOR

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore synon të përcaktojë parimet dhe procedurat që rregullojnë organizimin e studimeve themelore, baçelor, në Universitetin e Prishtinës, të sigurojë transparencë, barazi dhe standarde të larta akademike në procesin mësimor, si dhe të garantojë respektimin e integritetit dhe etikës akademike.
2. Me këtë rregullore përcaktohen kriteret specifike për organizimin dhe kushtet e regjistrimit në studime, kushtet e regjistrimit të vitit akademik, kohëzgjatja e studimeve, ndërrimi i programit të studimeve, procedura nga paraqitja e kërkesës, elaborimi deri në mbrojtjen e punimit të diplomës baçelor, si dhe çështjet tjera të rëndësishme për studimet themelore - baçelor, që zgjasin tre (3) ose katër (4) vjet dhe që kërkojnë 180, respektivisht 240 pikë të ECTS-së, në Universitetin e Prishtinës (në tekstin e mëtejme UP).
3. Përcaktimi i kriterëve specifike për organizimin dhe kushtet e regjistrimit në studime në programet që zgjasin deri në gjashtë (6) vjet dhe kërkojnë deri në 360 pikë të ECTS-

së, si dhe programet e integruara të studimeve, do të bëhet me rregullore të veçanta, të miratuara nga Senati i UP-së, me propozimin e këshillit të njësisë akademike përkatëse

Neni 2 Definicionet kryesore

1. Studimet baçelor përfaqësojnë ciklin e parë të arsimit të lartë, që synon pajisjen e studentëve me njohuri, shkathësi dhe kompetenca themelore profesionale e akademike, zakonisht me kohëzgjatje prej tre deri në katër vjet studimi dhe me përfundimin e të cilave studentit i jepet titulli akademik „Baçelor”.
2. Program studimi është një tërësi e organizuar e lëndëve, aktiviteteve mësimore dhe kërkesave akademike, që çojnë në fitimin e një titulli të caktuar akademik në përputhje me nivelin e studimeve.
3. Studime të rregullta organizohen me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të studentëve në procesin mësimor në hapësirat e universitetit, sipas orarit të përcaktuar dhe me regjistrim me kohë të plotë.
4. Studime online zhvillohen përmes platformave digjitale dhe mjeteve të mësimdhënies në distancë, duke mundësuar ndjekjen e ligjëratave, ushtrimeve dhe vlerësimeve në mënyrë virtuale.
5. Studime të kombinuara (*‘blended’*) përfshijnë ndërthurjen e formës tradicionale të mësimin në auditor me mësimin online, duke siguruar fleksibilitet dhe qasje të gjerë për studentët.
6. Studime të përbashkëta janë programe të zhvilluara në bashkëpunim midis dy ose më shumë institucioneve të akredituara të arsimit të lartë, ku studentët ndjekin pjesë të programit në secilin institucion partner.
7. Studime me diplomë të dyfishtë realizohen në bazë të marrëveshjeve ndëruniversitare, ku studenti plotëson kërkesat e dy programeve të akredituara dhe, pas përfundimit me sukses, fiton dy diploma nga institucionet përkatëse.
8. Baçelor i Arteve (BA) është titull akademik që u jepet studentëve pas përfundimit të suksesshëm të studimeve në fushat e arteve, shkencave humane, gjuhëve, edukimit apo disiplinave të ngjashme.
9. Baçelor i Shkencës (BSc) është titull akademik që u jepet studentëve pas përfundimit të studimeve në fushat e shkencave natyrore, inxhinierisë, teknologjisë, ekonomisë, matematikës apo disiplinave të aplikuara.
10. Student i rregullt është ai që ndjek studimet me kohë të plotë dhe merr pjesë rregullisht në procesin mësimor, sipas orarit dhe kriterëve të përcaktuara me syllabus.
11. Student me korrespondencë është ai që ndjek studimet me kohë të pjesshme ose në distancë, duke përmbushur kërkesat akademike përmes materialeve të mësimin në distancë dhe pjesëmarrjes së kufizuar në aktivitete të drejtpërdrejta.
12. Student vizitor është personi i regjistruar në një universitet tjetër që ndjek përkohësisht studimet ose pjesë të programit në Universitetin e Prishtinës, në bazë të marrëveshjeve bashkëpunuese ndërinstitutionale.

Neni 3

Organizimi dhe llojet e studimeve baçelor

1. Studimet në nivelin baçelor zhvillohen në kuadër të njësive akademike dhe në bashkëpunim ndërmjet njësive akademike për programet ndërdisiplinare, në përputhje me misionin e Universitetit të Prishtinës, standardet institucionale dhe kërkesat e akreditimit.
2. Studimet baçelor mund të realizohen gjithashtu në bashkëpunim me universitete të tjera, në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara me institucione të akredituara të arsimit të lartë në formë të studimeve të përbashkëta ose të dyfishta.
3. Studimet themelore (baçelor) kanë 180, respektivisht 240 pikë të ECTS-së, duke reflektuar ngarkesën 30 ECTS për një (1) semestër, varësisht nga natyra e programit dhe legjislacioni në fuqi për programet e rregulluara në Republikën e Kosovës.
4. Studimet themelore në fushën e Mjekësisë dhe Mjekësisë Veterinare zgjasin deri në gjashtë (6) vjet dhe kërkojnë deri në 360 pikë të ECTS-së, për të cilat senati miraton rregullore të veçantë.

Neni 4

Format e studimeve dhe statusi i studentit

1. Studimet baçelor mund të organizohen si:
 - 1.1. Studime të rregullta;
 - 1.2. Studime të rregullta online ose në format të kombinuar me prani fizike dhe online;
 - 1.3. Studime me korrespondencë, të cilat organizohen në pajtim me rregullat e veçanta të përcaktuara në programin e akredituar.
2. Në studimet themelore – baçelor, varësisht nga natyra e programit dhe kriteret e akreditimit, studentit mund të ketë statusin e:
 - 2.1. Studentit të rregullt;
 - 2.1. Studentit me korrespondencë;
 - 2.1. Studentit vizitor.
3. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve fitohet thirrja akademike „Baçelor i Shkencës” apo „Baçelor i Arteve”, varësisht nga natyra e programit.

Neni 5

Programet e studimeve

1. Përbajtja e programeve të studimeve për mësimdhënie përcaktohet, në bazë të rregulloreve në fuqi, nga këshilli i njësive akademike përkatëse, me propozim të komisionit të studimeve dhe komisionit për sigurimin e cilësisë dhe miratohet nga senati në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me standardet e përcaktuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.
2. Programet e studimit përbajnë:

- 2.1 Titullin e studimit;
 - 2.2 Llojin e studimit;
 - 2.3 Thirrjen akademike (titullin akademik);
 - 2.4 Kushtet për regjistrim;
 - 2.5 Objektivat dhe rezultatet;
 - 2.6 Hollësitë mbi përmbajtjet programore;
 - 2.7 Vlera në pikë sipas ECTS (lëndët, punimi i diplomës);
 - 2.8 Format dhe strategjitë e mësimdhënies;
 - 2.9 Metodatat e vlerësimit të studentëve;
 - 2.10 Literaturën bazë.
3. Përmbajtjet, strukturimi dhe procesi i hartimit të programeve dhe planprogrameve do të përcaktohen me rregullore të veçantë, të nxjerrë nga senati.

Neni 6

Studimet online (E-learning) dhe të kombinuara

1. Programet studimore mund të organizohen tërësisht në formën online, në rast se janë planifikuar e akredituar si programe që ofrohen në formën online.
2. Studimet online organizohen përmes platformave digjitale të mësimdhënies, të miratuara nga universiteti, duke siguruar qasje të barabartë për të gjithë studentët në ligjërata, materiale mësimore dhe aktivitete interaktive.
3. Pjesëmarrja e studentëve monitorohet në mënyrë elektronike, ndërsa vlerësimi i tyre realizohet përmes detyrave, provimeve dhe prezantimeve të dorëzuara online, në përputhje me rregulloren për vlerësimin e performancës së studentëve.
4. Përqindja maksimale e lëndëve/orëve të zhvilluara në formën online përcaktohet me udhëzim të veçantë të senatit, në përputhje me standardet e akreditimit kombëtar dhe evropian.
5. Provimet online miratohen paraprakisht nga dekanati i NjA-së, pas një arsyetimi nga mësimdhënësi i lëndës. Në këto raste njësitë akademike obligohen të sigurojnë verifikimin e identitetit të studentëve dhe ruajtjen e evidencave digjitale të pjesëmarrjes.

Neni 7

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs dhe regjistrimi në studime

Secili kandidat që e kalon testin e maturës gëzon të drejtën për të konkurruar për studime në nivelin baçelor. Kushtet për praninë në studimet themelore - baçelor janë:

1. Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme (mesme të lartë) me së paku 12 vjet të shkollimit në Kosovë, vërtetuar me diplomë përkatëse.
2. Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme (mesme të lartë) me së paku 12 vjet të shkollimit, vërtetuar me diplomë përkatëse, të fituar jashtë Republikës së Kosovës, në qoftë se është bërë barasvlerësimi me diplomën e maturës. Vendimi për njohjen e diplomës dhe barasvlerën merret nga ministria përkatëse.

3. Senati, sipas propozimit të njësisë akademike, në kuadër të konkurseve për pranimit të studentëve, përcakton kriteret e hollësishme të përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, organizimin e provimeve pranuese, procesin e ankimimit, deri në regjistrimin përfundimtar të studentëve.
4. Numri i studentëve të rinj për program studimor, kriteret e pranimit, përkatësisht regjistrimit, dinamika e rrjedhës së procesit, provimi pranues, shpallja e rezultatit preliminar, ankesat dhe shpallja e rezultatit final, në mënyrë të hollësishme, përcaktohen me konkurs publik, të shpallur nga Senati i UP-së, bazuar në statutin e UP-së dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Mbarëvajtja e procesit të pranimit të studentëve të rinj

1. Me qëllim të mbarëvajtjes së procesit të pranimit të studentëve të rinj, këshilli i njësisë akademike emëron komisionet përkatëse nga radhët e personelit të rregullt akademik të programit përkatës.
2. Përgjegjësitë dhe obligimet e komisioneve përcaktohen më hollësisht me vendimin e këshillit të njësisë akademike.
3. Anëtari i komisionit për pranimin e studentëve nuk mund të emërohet njëkohësisht edhe në komisionin për shqyrtimin e ankesave.
4. Anëtarët e menaxhmentit të njësisë akademike (dekani apo prodekanët) menaxhojnë procesin por nuk mund të shërbejnë në cilësinë e anëtarit të komisionit në asnjërën fazë, me përjashtim në Fakultetin e Arteve.
5. Zëvendësimi i anëtarit të komisionit për pranimin e studentëve dhe komisionit për shqyrtimin e ankesave bëhet sipas procedurës së emërimit.

Neni 9

Përzgjedhja e kandidatëve

1. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u mbështetur në kriteret e konkursit, ndërsa listat me rezultatet preliminare bëhen publike në ueb faqet e njësive akademike konform afateve të shpallura me konkurs.
2. Kandidatët e pakënaqur me rezultatin preliminar të provimit pranues kanë të drejtën e parashtrimit të ankesës brenda afatit të përcaktuar me konkurs.
3. Njësia akademike obligohet që vendimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe rezultatin përfundimtar t'i publikojë në ueb faqe brenda afateve të përcaktuara me konkurs.

Neni 10

Transparenca dhe informimi i studentëve për organizimin e procesit mësimor

1. Studentët, përmes ueb faqes, njoftohen me kohë lidhur me: strukturën e programit studimor, orarin e mësimit, orarin e konsultimeve me mësuesin, orarin e provimeve, përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me studimet përkatëse.
2. Orari i mësimit dhe orari i provimeve shpallen në fillim të vitit akademik, në përputhje me statutin e UP-së dhe mund të ndryshohen vetëm me miratimin paraprak të prodekanit përgjegjës për mësuesin dhe çështje për studentë.
3. Mësuesin janë të obliguar që në fillim të vitit të ri akademik t'i njoftojnë studentët me syllabuset e lëndëve, metodat dhe kriteret e përcaktimit të suksesit akademik, si dhe t'ua sigurojnë së paku dy termine në javë për konsultime.
4. Syllabuset, materialin mësimor dhe konfigurimin për vlerësimin e vazhdueshëm, mësuesin i lëndës është i obliguar t'i vendosë në platformën elektronike – Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (në vijim SEMS).

Neni 11

Kushtet e regjistrimit të vitit akademik

1. Studentët e pranuar në programet studimore të njësive akademike paraprakisht janë të obliguar të nënshkruajnë deklaratën e studentit me rastin e regjistrimit.
2. Regjistrimi i semestrave dhe mbledhja e ECTS-ve bëhet në përputhje me kornizën e Sistemit të Bolonjës dhe grumbullimi i së paku 30 ECTS-ve të vitit paraprak do të zbatohet në regjistrimin e vitit vijues.
3. Vlerësimi i studentëve të cilët nuk kanë arritur të përfundojnë të gjitha provimet e vitit paraprak dhe kanë fituar të drejtën e vijimit të ligjëratave për vitin pasues bëhet përmes Modullit të Vlerësimit të Vazhdueshëm në SEMS bazuar në Rregulloren për vlerësimin e vazhdueshëm. Ky vlerësim regjistrohet në transkriptë vetëm pas përfundimit të provimeve të vitit paraprak.
4. Përjashtimisht nga kriteri i përgjithshëm prej 30 ECTS-ve, kalimi në vitin vijues mund të kushtëzohet me përfundimin me sukses të lëndëve kryesore konform akreditimit të programit të studimit, sipas përcaktimit në syllabuse.
5. Senati mund të vendosë për rritjen e standardit nga paragrafi 2 i këtij neni, mbështetur në nenin 98, pikën 2 të statutit.
6. Studenti i cili nuk ka mundur të grumbullojë numrin e ECTS-ve sipas pikës 2 të këtij neni duhet sërish të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve.
7. Studenti duhet të përfundojë të gjitha obligimet e programit, duke përjashtuar realizimin e temës së diplomës baçelor, më së largu deri në dyfishin e kohëzgjatjes së studimeve sipas programit studimor.
8. Pagesat për studimet baçelor do të bëhen në bazë të tarifave të përcaktuara me udhëzimet administrative të MASHTI-t dhe vendimeve të Këshillit Drejtues të UP-së.
9. Studenti vitin akademik e fillon duke e bërë regjistrimin në semestrin dimëror.

10. Vërtetimi i semestrit dimëror është kusht për regjistrimin e studentit në semestrin veror.
11. Studenti i cili nuk i plotëson kushtet për regjistrimin në vitin vijues, sipas programit me të cilin i ka filluar studimet, obligohet të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve në program të riakredituar. Vendimin për këtë e merr këshilli i njësisë akademike me propozim të komisionit për studime, pas shqyrtimit të kërkesës së studentit.
12. Studentit, i cili nuk ka arritur ta fitojë kushtin për regjistrim në vitin vijues në programin, i cili nuk është riakredituar, i lejohet regjistrimi pa kusht në vitin vijues në programin, në të cilin i ka filluar studimet.

Neni 12

Regjistrimi i lëndëve obligative dhe zgjedhore në SEMS

1. Studentët obligohen të regjistrojnë të gjitha lëndët në llogarinë e tyre në SEMS.
2. Regjistrimi i semestrit dhe lëndëve në SEMS duhet të bëhet individualisht nga secili student më së largu deri më 30 shtator për semestrin dimëror, ndërsa më së largu deri më 15 shkurt për semestrin veror.
3. Lëndët obligative regjistrohen sipas kërkesave të programit të akredituar, për semestrin përkatës, i cili duhet të jetë i publikuar në ueb faqen e NjA-së.
4. Lëndët zgjedhore përzgjidhen bazuar në interesin dhe nevojat për zhvillim profesional të studentit. Përshkrimi i shkurtër i lëndëve zgjedhore është i publikuar në ueb faqe të NjA-së për orientim të studentëve.
5. Në pajtim me programin e studimeve, studenti mund të zgjedhë dhe të regjistrojë lëndë të caktuara në programe tjera të njësisë akademike dhe në njësitë tjera akademike të universitetit, në qoftë se lënda e zgjedhur nuk zhvillohet në fakultetin ku është i regjistruar studentit.
6. Regjistrimi i lëndës mund të bëhet me lejen e njësisë akademike ku është i regjistruar studentit dhe me pajtimin e njësisë akademike ku studentit e regjistron lëndën.
7. Me rastin e lejimit, studentit i jepet vërtetimi për lejimin për regjistrim të lëndës së caktuar dhe lartësia e ECTS kredive që do të fitohen me përfundimin e lëndës.
8. ECTS kreditë e fituara do t'i llogariten në programin e studimeve të studentit.
9. Përzgjedhja bëhet sipas afatit të specifikuar në pikën 2 të këtij neni. Për secilën lëndë zgjedhore NjA-ja përcakton numrin maksimal të studentëve për grup dhe përzgjedhja realizohet në SEMS sipas rregullit „kush e zgjedh i pari”. Për regjistrimin e lëndëve zgjedhore ku ka interesim më të lartë të studentëve sesa limiti i përcaktuar, mund të shtohet deri në 20% e kuotës për regjistrim të atyre lëndëve, por pa e rrezikuar mbajtjen e lëndëve të tjera zgjedhore.

Neni 13

Mësimdhënia dhe konsultimet me studentët

1. Mësimdhënia në programet baçelor organizohet në përputhje me planin dhe programin studimor të akredituar dhe përfshin ligjërata, ushtrime praktike, studio e projektimit,

- seminare, punë kërkimore, laboratorike apo aktivitete të tjera, në varësi të natyrës së lëndës.
2. Mësimdhënësit janë të obliguar të zhvillojnë procesin mësimor në mënyrë profesionale, të respektueshme dhe në përputhje me orarin e miratuar, duke përdorur metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit.
 3. Në fillim të çdo viti akademik, mësimdhënësi është i obliguar të njoftojë studentët me syllabuset e lëndëve, objektivat, përmbajtjen, metodologjinë e mësimdhënies, kriteret e vlerësimit dhe afatet për detyrat e kursit.
 4. Mësimdhënësit vizitorë, të angazhuar në bazë të marrëveshjeve ndëruniversitare ose bashkëpunimeve akademike, mund të zhvillojnë mësim në formë blloku për module ose lëndë të caktuara, në përputhje me planin studimor dhe kalendarin akademik të njësisë përkatëse.
 5. Mësimdhënësit janë të obliguar të caktojnë së paku dy orë konsultimi, dy herë në javë për studentët, (posaçërisht pas mbajtjes së provimeve përfundimtare) me qëllim ofrimin e mbështetjes akademike dhe sqarimeve shtesë mbi përmbajtjen e lëndës, detyrat dhe vlerësimet.
 6. Orari i konsultimeve duhet të jetë i publikuar në vendin e dukshëm në kabinetin e mësimdhënësit ose në hapësirat e përcaktuara nga njësia akademike.
 7. Konsultimet mund të realizohen edhe në formë elektronike, online, përmes platformave digjitale të miratuara nga universiteti, në raste të arsyeshme ose kur kjo formë lehtëson qasjen e studentëve.
 8. Mosrespektimi i orarit të ligjëratave apo i detyrimit për konsultime nga ana e mësimdhënësve konsiderohet shkelje e detyrimeve akademike dhe trajtohet sipas akteve përkatëse të Universitetit të Prishtinës.

Neni 14

Përbushja e obligimeve në pajtim me programin e studimit dhe paraqitja e provimeve

1. Staf i akademik i bën të qarta kriteret e suksesit për secilën lëndë në syllabus. Studenti nuk mund t'u nënshtrohet provimeve në lëndët, përkitazi me të cilat nuk i ka përbushur obligimet në pajtim me syllabusin e lëndës.
2. Paraqitja e provimeve për vitin vijues bëhet sipas pikës 3 dhe nënpikës 3.1 të nenit 11 të kësaj rregulloreje.
3. Vijimi i rregullt i procesit mësimor dhe kryerja e obligimeve të përcaktuara në programin e studimeve dhe syllabuse të lëndëve konfirmohet në fund të çdo semestri në platformën elektronike SEMS.
4. Specifikat e tjera rreth paraqitjes së provimeve në SEMS janë detajuar në Rregulloren për vlerësimin e performancës së studentëve.

Neni 15

Mbështetja dhe fleksibiliteti akademik për kategori të veçanta të studentëve

1. Universiteti siguron akomodime të arsyeshme për studentët me aftësi të kufizuara, studentët me probleme serioze shëndetësore të vërtetuar nga mjeku, si dhe për studentët sportistë elitare ose ata që përfaqësojnë Republikën e Kosovës dhe universitetin në aktivitete zyrtare (gara, konferenca, projekte shkencore, aktivitete kulturore ose sportive zyrtare).
2. Përjashtimet nga pjesëmarrja e rregullt, për një kohë të limituar, pranohen për raste të dokumentuara si sëmundje, apo shkaqe të tjera të arsyeshme të pranuar nga prodekani për mësim.
3. Akomodimet mund të përfshijnë: shtyrjen e afateve, modalitete alternative të vlerësimit, fleksibilitet në orare dhe asistencë të personalizuar, në përputhje me dokumentacionin mbështetës dhe kërkesën e studentit.
4. Për çdo rast të tillë, studenti duhet të paraqesë kërkesë të arsyetuar dhe dokumentacionin mbështetës te prodekani për mësim.
5. Universiteti garanton barazi të plotë dhe mosdiskriminim në vlerësim, afate dhe trajtim akademik, në përputhje me parimet dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 16

Ndërrimi i programit

1. Ndërrimi i programit, vazhdimi i studimeve, njohja e provimeve dhe mobiliteti janë përcaktuar me nenet 110, 111, 112 dhe 113 të Statutit të UP-së dhe rregulloren përkatëse të miratuar nga Senati i UP-së.
2. Studenti mund të ndërrojë programin duke kaluar në program të ri në vitin e dytë e tutje të studimeve në rast të ndërrimit të programit, si për shembull ndryshimet në emërtim të programit pas procesit të akreditimit/riakreditimit.
3. Studenti mund të ndryshojë drejtimin e studimit duke kaluar në një program të afërt brenda ose jashtë njësisë akademike dhe procesi i lejitimit të lëvizjes, kriteret dhe ekuivalentimi i arritjeve në programin e vjetër vendosen nga njësia akademike, por duke mos ra ndesh me dispozitat e statutit dhe aktet tjera të universitetit.
4. Njësitë akademike nuk duhet të anashkalojnë kapacitetet në dispozicion për programin, në të cilin regjistrohet studenti, si dhe respektojnë kufizimet në kuotat për atë program, të caktuara nga autoriteti i akreditimit. Ndërrimi i drejtimin të studimit nuk mund të bëhet nëse studenti nuk ka kryer obligimet e vitit të parë në programin e vjetër.
5. Studenti duhet t'ia dorëzojë kërkesën për ndërrimin e programit të studimit komisionit për studime të njësisë akademike, ku dëshiron t'i vazhdojë studimet. Bashkëngjitur me kërkesën duhet të ofrohet evidenca për plotësimin e suksesshëm të kërkesave bazuar në programin e mëparshëm të studimit.
6. Komisioni i studimeve përcakton detyrimet individuale për ndërrimin e programit të studimit në pajtim me rregullat e caktuara të programit të studimit.

7. Vendimi për ndërrimin e programit të studimit duhet të merret nga këshilli i njësive akademike me propozimin e komisionit të studimeve.
8. Gjatë ndërrimit të programit të studimit prej një universiteti tjetër në Universitetin e Prishtinës do të vlejnjë rregullat e njëjta si ato gjatë ndërrimit të programit të studimit brenda universitetit.
9. Kërkesa për ndërrimin e programit të studimeve për vazhdimin e studimeve dhe për njohjen e provimeve duhet të bëhet para fillimit të vitit akademik. Lidhur me dinamikën e procedurës, kohën e parashtrimit, dokumentacionin që duhet t'i bashkëngjitet kërkesës, mënyrën e parashtrimit, si dhe afatin e përmbylljes së kërkesës, studentët do të njoftohen me kohë në ueb faqe të njësive akademike përkatëse.
10. Shërbimi i studentëve njofton studentin edhe individualisht për vendimmarrjen e këshillit të njësive akademike nëpërmjet publikimit të vendimit në platformën elektronike SEMS.
11. Në kërkesën për ndërrim të programit të studimeve, konform nenit 111 të statutit, studenti duhet të shënojë edhe vitin e studimeve, në të cilin dëshiron të transferohet.
12. Procedura e ndërrimit të programit të studimeve është konkurruese dhe e bazuar në meritokraci. Kriteret kryesore të vlerësimit janë: (1) numri i ECTS pikëve të grumbulluara nga provimet dhe (2) notat përkatëse nga provimet e dhëna. Renditja e studentëve do të bëhet duke mbledhur produktet respektive ECTS kredi me notën, për çdo provim të kaluar. Pra pikët totale janë: $\sum(\text{ECTS} \times \text{nota})$, për çdo provim të kaluar në vitin paraprak. Numri maksimal i pikëve që mund të marrë një student për kalim në vitin e dytë është: $60 \text{ ECTS} \times 10 = 600$ pikë, gjegjësisht për kalim në vitin e tretë është: $2 \times 60 \text{ ECTS} \times 10 = 1200$ pikë, e kështu me radhë. Supozimi i bazuar është se viti akademik paraprak ka 30 ECTS për semestër, për 2 semestra ka 60 ECTS, dhe notat kaluese janë nga 6 deri në 10.
13. Në rast se numri i pikëve është i barabartë, përparësi do t'i jepet studentit me numër më të madh të provimeve të përfunduara. Në të kundërtën, përzgjedhja bëhet me short transparent dhe në prani të studentëve.
14. Lista e renditjes së studentëve, sipas pikëve të mbledhura konform formulës nga pika 13, përgatitet nga prodekan i për mësim, ndërsa vendimi merret nga këshilli i fakultetit.
15. Kërkesat e studentëve për ndërrimin e programit të studimeve, vazhdimin e studimeve dhe njohjen e provimeve shqyrtohen nga komisioni për studime të njësive akademike.

Neni 17 Vazhdimi i studimeve

1. Studentit që nuk arrin t'i përfundojë studimet në programin studimor, në të cilin është regjistruar (brenda afatit të përcaktuar me statut) mund t'i vazhdohet periudha e përfundimit të studimeve ose t'i lejohet vazhdimi i studimeve në programin e ri të studimeve (të riakredituar), me kusht që një vazhdim i tillë është paraparë me vendim të veçantë të Senatit të UP-së.
2. Në rast të lejimit të vazhdimit të studimeve, sipas programit të ri të studimeve (të riakredituar), studenti duhet t'u nënshtrohet provimeve vetëm në ato lëndë, të cilat nuk

- kanë qenë pjesë e programit paraprak ose që nuk i njihen me rastin e vazhdimit të studimeve në programin e ri (të riakredituar).
3. Në rast se programi pëson ndryshime më shumë se 50 % ose është mbyllur, atëherë procedohet sipas nenit 16 të kësaj rregulloreje.
 4. Departamenti, udhëheqësi apo koordinatori i programit (në rastin kur nuk ka departament), me kërkesën e prodekanit për mesimdhënie dhe çështje për studentë apo prodekanit për studime baçelor, propozon krahasueshmërinë dhe barasvlerën e programeve studimore pararendëse me ato të riakredituara, për nevojat e komisionit të studimeve.
 5. Në bazë të propozimit/raportit sipas paragrafit 2 të këtij neni, komisioni i studimeve i njësisë akademike i trajton kërkesat e studentëve dhe i procedon për shqyrtim të mëtejshëm në këshill të njësisë akademike.
 6. Këshilli i njësisë akademike merr vendim lidhur me propozimin e komisionit të studimeve.
 7. Lidhur me vendimin e këshillit të njësisë akademike duhet të njoftohet pa vonesë shërbimi përkatës i universitetit.
 8. Për rastet e ndërrimit të programit të studimit prej një universiteti tjetër në Universitetin e Prishtinës do të vlejnjë rregullat e njëjta si ato gjatë ndërrimit të programit të studimit brenda universitetit.
 9. Në rast se studenti, pasi të përfundojë studimet në një program studimor, aplikon dhe regjistrohet në program të ri studimor, nuk mund të konsiderohet ndërrim programi.
 10. Në raste të tilla, studenti obligohet të ndjekë ligjëratat dhe t'u nënshtrohet provimeve, njëjtë sikurse studentët e tjerë.

Neni 18 **Njohja e provimeve**

1. Studenti gëzon të drejtën të parashtrojë kërkesë për pranimin e provimeve nga programi i mëparshëm në programin e ri studimor.
2. Shqyrtimi i kërkesës për njohjen e notave të provimeve të dhëna në programin e mëparshëm studimor bëhet nga komisioni i studimeve, ndërsa vendimi merret nga këshilli i fakultetit.
3. Pas njohjes së notave, studenti është i obliguar të ndjekë vitet e studimit në programin e ri studimor të regjistruar, pa mundësi të tejkalimit të viteve të studimit.
4. Në një program studimi, në vitin e dytë, të tretë ose më shumë, nëse parashihen me program studimi, nuk mund të regjistrohen për herë të parë më shumë studentë sesa numri i lejuar nga AKA-ja për atë program studimi.

Neni 19

Mobiliteti i studentëve dhe njohja e kredive

1. Në pajtim me programin e studimeve, studenti mund të zgjedhë dhe të regjistrojë lëndë të caktuara nga programe tjera dhe njësitë tjera akademike të universitetit në qoftë se lënda e zgjedhur nuk zhvillohet në programin/fakultetin ku është i regjistruar studenti.
2. Regjistrimi i lëndës mund të bëhet me lejen e njësisë akademike ku është i regjistruar studenti dhe me pajtimin e njësisë akademike ku studenti e regjistron lëndën.
3. Me rastin e lejimit, studentit i jepet vërtetimi për lejimin për regjistrim të lëndës së caktuar dhe lartësia e ECTS kredive që do të fitohen me përfundimin e lëndës. ECTS kreditë e fituara do t'i llogariten në programin e studimeve të studentit.
4. Në dokumentin zyrtar të studentit shënohen të dhënat për lëndën e regjistruar, përmbushja e obligimeve të studentit dhe suksesi i treguar. Për ECTS kreditë e fituara, studentit i lëshohet dëshmi nga njësi akademike ku studenti i ka fituar ato.
5. Mobiliteti ndërkombëtar i studentëve dhe në mes të universiteteve në Kosovë rregullohet me akt të veçantë të universitetit. Me këtë akt dhe me marrëveshje me universitetin prej nga vjen studenti mysafir do të rregullohen edhe të drejtat dhe obligimet e studentit mysafir, pagesat për studime dhe çështje tjera lidhur me studentin mysafir. Akti i njëjtë rregullon edhe dispozitat e qëndrimit të studentëve të universitetit në një universitet jashtë Kosovës, në kuadër të marrëveshjeve për mobilitet.
6. Kreditë e fituara gjatë periudhave të mobilitetit studentor në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të mbështetura në Marrëveshjen e Studimeve (Learning Agreement) njihen automatikisht dhe pa procedura shtesë, përveç rasteve kur dokumentohet mospërputhje thelbësore në rezultatet e të nxënit.
7. Njohja bëhet sipas parimit „recognition by default”. Shërbimi i studentëve obligohet të konvertojë kreditë në SEMS brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e ‘Transcript of Records’.
8. Studentit nuk i kërkohet dhënia e provimeve shtesë për kreditë e njohura nga mobiliteti, përveç kur justifikohet me shkrim mospërputhja e rezultateve të të nxënit.
9. Në rast se lëndët e ndjekura në universitetet partnere kanë dallime thelbësore nga lëndët e programit në të cilin studenti është i regjistruar dhe nuk mund të pranohen si lëndë zgjedhore, ato duhet të regjistrohen si kredi shtesë (ekstra kredi) në transkriptin e notave dhe shtojcë të diplomës.

Neni 20

Çregjistrimi nga studimet, rifitimi i statusit të studentit dhe njohja e periudhës paraprake të studimeve

1. Çregjistrimi i studentit bëhet përmes platformës elektronike SEMS nga shërbimi për studentë në Administratën Qendrore të UP-së, pas aprovimit paraprak të kërkesës së studentit nga njësi akademike.
2. Kërkesën për çregjistrim studenti mund ta parashtrojë personalisht apo përmes personit tjetër të autorizuar me akt notarial.

3. Me rastin e aprovimit nga njësi akademike të kërkesës për çregjistrim, studenti e tërheq edhe dokumentacionin shkollor, të dorëzuar me rastin e aplikimit për regjistrim në universitet.
4. Studentit të çregjistruar nuk i lejohet të ketë qasje në shërbimet elektronike përmes platformës SEMS, por gëzon të drejtën e pajisjes me vërtetim për statusin e studentit, transkript të notave ose dokument tjetër standard.
5. Përjashtimisht, studenti ka të drejtë ta tërheqë përkohësisht dokumentacionin shkollor, duke dorëzuar kartelën e studentit. Studenti obligohet në kthimin e dokumentacionit brenda pesë (5) ditëve të punës nga dita e tërheqjes, në të kundërtën konsiderohet i çregjistruar.
6. Studenti i çregjistruar e rifiton statusin e studentit me rastin e regjistrimit të studimeve në ndonjërin nga programet e akredituara, sipas rregullave të konkursit publik.
7. Me rastin e çregjistrimit të studentit, universiteti është i obliguar t'i lëshojë studentit një certifikatë, në të cilën përfshihen emri i programit të studimit, si dhe emri i lëndës, nota dhe numri i kredive ECTS për secilën lëndë në të cilën studentit ka dhënë provimin.

Neni 21

Vlerësimi dhe përcaktimi i suksesit akademik

Vlerësimi dhe përcaktimi i suksesit akademik të studentit si dhe të gjitha aspektet që rrjedhin nga vlerësimi bëhen sipas neneve 114, 115, 116, 117 dhe 118 të Statutit të UP-së dhe Rregullores për vlerësimin e performancës së studentëve, të miratuar nga senati.

Neni 22

Integriteti akademik dhe mirësjellja e studentëve

1. Integriteti akademik nënkupton respektimin e parimeve të ndershmerisë intelektuale, përgjegjësisë personale dhe sjelljes etike në të gjitha aktivitetet studimore, kërkimore dhe institucionale të studentit.
2. Studentët janë të detyruar të kryejnë detyrimet akademike dhe kërkimore në mënyrë të pavarur dhe të ndershme, duke shmangur çdo formë të mashtrimit, plagjiaturës, falsifikimit, përvetësimit të punës së tjetrit apo manipulimit të të dhënave.
3. Çdo veprim që bie ndesh me integritetin akademik, përfshirë kopjimin në provime, përdorimin e burimeve të palejuara, dorëzimin e punimeve të huaja si të vetat ose manipulimin me dokumente zyrtare, përbën shkelje të rëndë disiplinore dhe sanksionohet sipas akteve përkatëse të Universitetit të Prishtinës dhe legjislacionit në fuqi.
4. Studentët janë të detyruar të tregojnë mirësjellje, respekt dhe përgjegjësi në raport me mësimdhënësit, studentët e tjerë, stafin administrativ dhe ambientin universitar, duke kontribuar në krijimin e një klime akademike të bazuar në tolerancë, respekt të ndërsjellë dhe barazi.

5. Universiteti është i obliguar të promovojë dhe mbështesë kulturën e integritetit akademik përmes politikave të brendshme, trajnimeve orientuese dhe mekanizmave parandalues, me qëllim të forcimit të etikës dhe përgjegjësisë akademike të studentëve.
6. Në kuadër të rregullativës mbi integritetin akademik përfshihet edhe përdorimi i inteligjencës artificiale (IA).

Neni 23

Përfundimi i studimeve dhe provimi i diplomës

1. Studentët mund t'i përfundojnë studimet me mbrojtjen e punimit të diplomës baçelor, me projekt përfundimtar, me dhënien e provimit gjithëpërfshirës para komisionit ose me dhënien e provimit të fundit, respektivisht sipas specifikave të programit të akredituar. Fakultetet mund të përcaktojnë forma alternative të vlerësimit përfundimtar (p.sh. portofol, projekt praktik, ekspozitë, performancë) në përputhje me natyrën e fushës së studimit.
2. Punimi i diplomës për nivelin baçelor të studimeve punohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar se aftësitë teorike dhe praktike, të arritura gjatë kohës së studimit, mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve në fushat e caktuara shkencore/kreative.
3. Punimi i diplomës për baçelor mund të punohet bashkë nga dy ose tre studentë (grup hulumtues).
4. Lidhur me kërkesën për elaborimin e punimit të diplomës për baçelor nga dy (2) ose tre (3) studentë vendoset nga këshilli i njësisë akademike.
5. Në rast të punimeve të përbashkëta të realizuara nga dy (2) ose tre (3) studentë, secili kandidat duhet të ketë të përcaktuar kontributin individual përmes ndarjes së qartë të kapitujve/komponenteve.
6. Para mbrojtjes publike, çdo punim i diplomës i nënshtrohet verifikimit për plagjiaturë dhe studenti/ët duhet të dorëzojnë deklaratë me shkrim mbi origjinalitetin e punës.
7. Punimi i diplomës ka peshë në numër të caktuar të ECTS-ve në varësi të programit studimor dhe kontribuon me përqindje % të caktuar në llogaritjen e notës mesatare të përgjithshme (GPA).

Neni 24

Inicimi i procedurës, elaborimi dhe shqyrtimi i kërkesës për lejimin e punimit të diplomës për baçelor

1. Studenti ka të drejtë ta paraqesë kërkesën për nisjen e procedurave për punimin e diplomës baçelor, pasi të ketë fituar kushtin për vitin e fundit të studimeve në kuadër të programit.
2. Pasi të jetë konsultuar dhe ta ketë marrë konfirmimin e mentorit potencial të punimit të diplomës baçelor, studenti ia dorëzon kërkesën njësisë akademike (Formularin F1-B), përkatësisht shërbimit të studentëve.

3. Departamenti e shqyrton kërkesën dhe, në rast të aprovimit, cakton mentorin dhe komisionin për mbrojtje. Përkitazi me këtë, departamenti e përpilon procesverbalin me listën e studentëve dhe mentorëve dhe ia përcjell zyrtarit administrativ përkatës.
- 3.1. Në rastet kur nuk arrin ta marrë aprovimin e një mësimdhënësi për mentorim, studenti ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë departamentit për lejimin e punimit të diplomës baçelor dhe caktimin e një mentori. Lidhur me kërkesën, departamenti vendos brenda një muaji nga data e parashtrimit të kërkesës.
4. Në njësitë akademike, në të cilat nuk ka departamente ose në rastet kur numri i anëtarëve të departamentit është më i vogël se 3, kërkesa si në paragrafin 3 të këtij neni trajtohet nga udhëheqësi ose koordinatori i programit, pas konsultimit me mentorin potencial.
5. Në rastet kur nuk funksionon asnjëra nga instancat si në paragrafin 5, kërkesa si në paragrafin 3 të këtij neni trajtohet nga komisioni për studime i njësisë akademike.
6. Dinamika e procesit të diplomimit publikohet në ueb faqen e njësisë akademike.

Neni 25

Mentorimi dhe komisioni për mbrojtje publike

1. Mentor mund të jetë mësimdhënësi nga personeli akademik, i cili të paktën është Dr. sc. i punësuar në UP ose ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve.
2. Anëtarët e komisionit për mbrojtjen publike të punimit të diplomës së baçelorit emërohen nga radhët e personelit të rregullt akademik të UP-së dhe jashtë tij (nga universitetet tjera të akredituara dhe në përputhje me fushën e studimeve). Për emërimin e anëtarëve të jashtëm vendos këshilli i njësisë akademike, mbështetur në propozimin e arsyetuar të departamentit.
3. Kryetar i komisionit për mbrojtje publike duhet të jetë mësimdhënësi i fushës përkatëse dhe duhet të ketë së paku thirrjen akademike profesor asistent.
4. Në cilësinë e anëtarit, por jo kryetar i komisionit për mbrojtje publike, është edhe mentori i kandidatit.
5. Anëtar i komisionit, por jo mentor, mund të caktohet edhe asistenti i autorizuar për mbajtjen e ligjëratave.
6. Në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, në njësitë akademike ku është relevante, anëtar i komisionit mund të caktohet edhe lektori i gjuhëve të huaja.

Neni 26

Punimi i temës së diplomës

1. Punimi i temës së diplomës përbën fazën përfundimtare të studimeve baçelor dhe synon të vërtetojë aftësinë e studentit për të aplikuar njohuritë teorike dhe praktike të fituara gjatë studimeve në zgjidhjen e një problemi konkret brenda fushës përkatëse të studimit.

2. Tema e diplomës duhet të jetë në përputhje me fushën e programit studimor dhe përcaktohet në bashkëpunim midis studentit dhe mësimit udhëheqës, i cili miratohet nga këshilli i njësive akademike.
3. Punimi i diplomës duhet të jetë rezultat i punës individuale të studentit, të respektojë parimet e integritetit akademik dhe të përmbajë referenca të plota sipas standardeve të cituara shkencore.
4. Punimi i diplomës së bachelorit duhet të jetë i përgatitur në pajtim me normat e shkrimit akademik, sipas udhëzuesit për temën e diplomës bachelor të UP-së.
5. Formatin, strukturën dhe procedurat e mbrojtjes së temës së diplomës, Universiteti i Prishtinës i përcakton me udhëzues të veçantë, të miratuar nga senati i universitetit.
6. Tema e diplomës duhet të përmbajë edhe deklaratën e origjinalitetit dhe të shfrytëzimit të veglave të bazuara në inteligjencën artificiale.
7. Punimin e diplomës studenti e dorëzon në tri (3) kopje fizike (të protokolluar) dhe në një format elektronik të standardizuar, së paku shtatë (7) ditë para mbrojtjes publike.
8. Në Fakultetin e Arteve punimi i diplomës mund të realizohet jo vetëm përmes punimit të shkruar, por edhe përmes formave artistike të fushës përkatëse, si p.sh. ekspozita, shfaqje teatrore, film, koncert, recital muzikor (piano, instrumente të tjera), apo performanca të tjera krijuese që lidhen me drejtimin e studimeve. Fakulteti i Arteve përgatitë udhëzues të veçantë për provimin e diplomës, duke përfshirë specifikat e të gjitha departamenteve/programeve.

Neni 27

Mbrojtja publike e punimit të diplomës bachelor

1. Mbrojtja publike e punimit të diplomës bachelor bëhet pasi studentit t'i ketë përfunduar të gjitha provimet e parapara dhe obligimet e tjera në përputhje me programin përkatës të studimeve.
2. Përfundimin e të gjitha provimeve, përmbushjen e obligimeve tjera në përputhje me programin përkatës të studimeve dhe kërkesave të tjera të natyrës administrative i konstaton shërbimi i studentëve, së paku pesë (5) ditë para mbrojtjes publike.
3. Lidhur me përmbushjen e obligimeve të studentit në përputhje me programin përkatës të studimeve dhe kërkesave të tjera të natyrës administrative, shërbimi i studentëve shkarkon nga platforma elektronike SEMS raportin për mbrojtjen publike dhe vlerësimin përfundimtar (formulari F2B), të cilin obligohet ta tërheqë komisioni ose mentori i kandidatit para mbrojtjes publike.
4. Data e mbrojtjes caktohet jo më herët se pesë (5) ditë kalendarike nga data e përfundimit të provimit të fundit.
7. Prej datës kur aprovohet kërkesa për lejimin e punimit të diplomës bachelor dhe caktimin e mentorit deri në datën e mbrojtjes publike duhet të kalojë së paku një (1) muaj, por jo më shumë se një (1) vit kalendarik.
8. Studenti ka të drejtë vetëm një herë të paraqesë kërkesë me dëshmi për vazhdimin e afatit për mbrojtjen e punimit të diplomës. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet pëlqimi me shkrim i mentorit se tema është aktuale dhe dëshmia përkatëse për arsyet e vonesave, që

- kanë pamundësuar përfundimin e temës me kohë. Dekani i njësisë akademike e shqyrton kërkesën për shtyrje të afatit të mbrojtës publike të diplomës.
9. Mbrojtja e punimit të diplomës së baçelorit është publike dhe zhvillohet para komisionit të emëruar sipas nenit 25 të kësaj rregulloreje.
 10. Pas mbrojtjes publike, nëse punimi i diplomës baçelor i kandidatit është vlerësuar pozitivisht, komisioni plotëson raportin si në paragrafin 3 të nenit 27 të kësaj rregulloreje, i cili rikthehet në shërbimin e studentëve.
 11. Notën e vlerësimit përfundimtar në platformën elektronike SEMS e vendos mentori i kandidatit.
 12. Mentori, raportin e plotësuar dhe të nënshkruar nga komisioni për mbrojtje publike, së bashku me fletëparaqitjen fizike të gjeneruar nga platforma elektronike SEMS pas notimit, i dorëzon në shërbimin e studentëve. Ky dokumentacion bëhet pjesë e dosjes së kandidatit.
 13. Kandidati, i cili nuk e ka mbrojtur me sukses punimin e diplomës baçelor, ka të drejtën e riorganizimit të mbrojtjes publike brenda tre (3) muajsh. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë.
 14. Suksesi i përgjithshëm i studentit në fund të studimeve përcaktohet me notën mesatare, e cila paraqet mesataren përfundimtare të notave kaluese të të gjitha provimeve, përfshirë provimin e punimit të diplomës.
 15. Universiteti, me vendim të veçantë, parasheh çfarë duhet të përmbajë dosja e studentit të diplomuar, para se t'i lëshohen certifikata e diplomimit dhe diploma.

Neni 28 **Titulli akademik**

1. Studenti, pas përfundimit të studimeve themelore – baçelor, e merr titullin „Baçelor i Shkencës” ose „Baçelor i Arteve”, sipas programit të akredituar.
2. Deri në ditën e marrjes së diplomës, studentit i lëshohet certifikata e diplomimit, e nënshkruar nga dekani i fakultetit.
3. Me rastin e marrjes së diplomës, njësia akademike duhet t'ia ofrojë kandidatit edhe shtojcën e diplomës.

Neni 29 **Dispozitat kalimtare**

1. Të gjitha veprimet dhe procedurat nga fushëveprimi i kësaj rregulloreje, të filluara me akte paraprake, duhet të përfundojnë më së largu tre (3) muaj nga aprovimi i kësaj rregulloreje.
2. Për të gjitha çështjet, të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës, Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe aktet tjera të nxjerra nga organet e universitetit.

Neni 30 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja nr. 22 e datës 13.01.2022 për studimet themelore – baçelor.

Neni 31 Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Senati i Universitetit të Prishtinës.
2. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë edhe formularët nga SEMS (F1-B dhe F2-B) si dhe Udhëzuesi për temën e diplomës për studentët e programeve Baçelor.
3. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen me procedurën e njëjtë me të cilën është miratuar.



Prof. Arben Hajrullahu,

[Handwritten signature]
Rector dhe kryesues i Senatit të UP-së.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu

Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: _____

Datë: ____/____/____

FORMULARI F1-B

Për departamentin: _____

Nga: _____, ID: _____

(Emri dhe mbiemri i studentit)

(Numri i ID-së së studentit)

E-maili i studentit: _____

Programi studimor: _____

Lënda: Kërkesë¹ për lejimin e punimit të diplomës baçelor dhe caktimin e mentorit

Mbështetur në Rregulloren për studime baçelor në UP, kërkoj nga departamenti i sipërshënuar ta lejojë punimin e diplomës baçelor, me titull:

_____ dhe ta miratojë propozimin për caktimin e Prof. _____ në cilësinë e mentorit.

_____ ¹ Kërkesa dorëzohet nga studenti pasi të jetë konsultuar dhe ta ketë marrë konfirmimin me nënshkrim të mentorit potencial.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu

Ueb: www.uni-pr.edu

FORMULARI F2-B (Plotësohet nga administrata)

RAPORT²

i shqyrtimit të kërkesës për lejin e punimit të diplomës baçelor dhe miratimit të propozimit për mentor

Departamenti i _____, në mbledhjen e mbajtur me datë _____, ka shqyrtuar kërkesën e studentit _____ për lejin e punimit të diplomës baçelor me titull:

_____ dhe caktimin e Prof. _____ në cilësinë e mentorit.

Duke marrë parasysh këtë, departamenti miraton kërkesën për lejin e punimit të diplomës baçelor dhe propozimin për mentor, si dhe emëron komisionin për vlerësim dhe mbrojtje me këtë përbërje:

1. _____ - kryetar
2. _____ - anëtar
3. _____ - anëtar

Arsyetimi me rastin e refuzimit të kërkesës dhe propozimi i departamentit:

_____.

Zyrtari i administratës:

² Ky raport, së bashku me kërkesën e studentit bëhet pjesë përbërëse e dosjes së studentit.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu
Ueb: www.uni-pr.edu

UDHËZUES PËR TEMËN E DIPLOMËS

Për studentët e programeve Bachelor

Prishtinë, 2026

HYRJE

Punimi i diplomës në nivelin Baçelor në Universitetin e Prishtinës paraqet fazën përmbyllëse të studimeve universitare të ciklit të parë dhe përbën një nga komponentët më të rëndësishëm të procesit akademik. Ai realizohet në përputhje me planprogramin përkatës të studimit, rregulloret në fuqi të universitetit dhe standardet e përgjithshme të arsimit të lartë. Si i tillë, punimi i diplomës nuk është vetëm një detyrim formal për përfundimin e studimeve, por një dëshmi konkrete e përgatitjes profesionale dhe shkencore të studentit.

Nëpërmjet këtij punimi, studenti demonstroi aftësinë për të integruar njohuritë teorike dhe praktike të fituara gjatë viteve të studimit, për t'i analizuar ato në mënyrë kritike dhe për t'i zbatuar në trajtimin e një çështjeje apo problemi të caktuar nga fusha përkatëse e studimit. Punimi i diplomës synon të zhvillojë dhe të vlerësojë kompetencat hulumtuese, analitike dhe metodologjike të studentit, si dhe aftësinë e tij për të strukturuar, argumentuar dhe prezantuar në mënyrë të qartë e të saktë rezultatet e punës së tij akademike.

Procesi i përgatitjes së punimit të diplomës përfshin disa faza të rëndësishme, duke filluar nga përzgjedhja dhe miratimi i temës, hartimi i projekt-propozimit, mbledhja dhe analizimi i literaturës relevante, përzgjedhja e metodologjisë së përshtatshme hulumtuese, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, deri te interpretimi i rezultateve dhe formulimi i përfundimeve dhe rekomandimeve. Secila prej këtyre fazave kërkon përkushtim, planifikim të kujdesshëm dhe menaxhim efektiv të kohës.

Përzgjedhja e temës së punimit duhet të bëhet në përputhje me profilin e programit të studimit dhe interesimet akademike të studentit, duke pasur parasysh relevancën shkencore dhe praktike të saj. Tema duhet të jetë e qartë, e realizueshme brenda afatit të përcaktuar dhe e mbështetur në literaturë bashkëkohore e kredibile. Në këtë kontekst, bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet studentit dhe mentorit është thelbësor. Mentori luan rol udhëheqës dhe këshillimor gjatë gjithë procesit, duke orientuar studentin në aspektin metodologjik, teorik dhe etik të hulumtimit, por përgjegjësia kryesore për realizimin e punimit mbetet te studenti.

Shkrimi i punimit të diplomës kërkon respektim rigoroz të standardeve të shkrimit akademik dhe të etikës shkencore. Studenti duhet të demonstrojë aftësi për të përdorur burime të besueshme, për të cituar dhe referencuar saktë sipas stilit të kërkuar, si dhe për të shmangur çdo formë të plagjiaturës.

Integriteti akademik përbën një nga parimet themelore të veprimtarisë universitare dhe është kusht i domosdoshëm për vlerësimin pozitiv të punimit.

Përveç aspektit hulumtues, punimi i diplomës ka edhe dimension formativ dhe profesional. Ai kontribuon në zhvillimin e aftësive të komunikimit shkencor, të mendimit kritik, të zgjidhjes së problemeve dhe të punës së pavarur. Përmes këtij procesi, studenti përgatitet për sfidat e tregut të punës, për studime të mëtejshme në ciklin e dytë (Master), si dhe për përfshirje në aktivitete kërkimore e profesionale në fushën përkatëse.

Ky udhëzues ka për qëllim të ofrojë orientime të qarta dhe të strukturuar lidhur me përmbajtjen, organizimin, standardet teknike dhe procedurat administrative që ndërlidhen me përgatitjen, dorëzimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës në nivelin Baçelor në Universitetin e Prishtinës. Ai synon të lehtësojë procesin e punës së studentit dhe të sigurojë një qasje të unifikuar në përputhje me kërkesat institucionale dhe akademike.

Megjithatë, ky dokument nuk zëvendëson literaturën bazë të metodologjisë së hulumtimit dhe as konsultimet e drejtpërdrejta me mentorin. Përkundrazi, ai duhet të përdoret në mënyrë komplementare me burimet shkencore përkatëse dhe me udhëzimet e mentorit, duke respektuar rregulloret dhe aktet normative të Universitetit të Prishtinës. Zbatimi i këtyre udhëzimeve garanton një proces të strukturuar, transparent dhe cilësor, duke siguruar që punimi i diplomës të përmbushë standardet akademike dhe të reflektojë nivelin e arritur të kompetencave të studentit në përfundim të studimeve Baçelor.

PUNIMI I DIPLOMËS NË PROGRAMET BACHELOR: STANDARDET DHE PROCESI

Punimi i diplomës në programet Baçelor të Universitetit të Prishtinës përbën një komponent të detyrueshëm akademik dhe kusht për përfundimin e suksesshëm të studimeve të ciklit të parë. Ai duhet të jetë në përputhje me profilin dhe natyrën e programit përkatës të studimit dhe të reflektojë kompetencat profesionale dhe shkencore të fituara gjatë studimeve.

Punimi i diplomës duhet të ketë një vëllim orientues prej 8000 – 10000 fjalësh (afërsisht 30 – 50 faqe), pa përfshirë shtojcat dhe literaturën. Struktura, përmbajtja dhe forma teknike e punimit duhet të jenë në përputhje me standardet e shkrimit akademik dhe me udhëzimet e miratuara nga njësi akademike përkatëse.

Lloji i punimit

Punimi i diplomës në programet e ciklit të parë në UP mund të jetë:

- **Empirik**, i bazuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave primare dhe/ose sekondare;
- **Teorik**, i mbështetur në analizë të thelluar dhe kritike të literaturës shkencore ekzistuese;
- **Projekt arkitektonik**, i cili paraqet një zgjidhje të plotë konceptuale dhe teknike për një hapësirë ose objekt ndërtimor, duke integruar funksionin, estetikën dhe kontekstin urban;
- **Projekt artistik**, në formë të një krijimi individual që shpreh ide, emocione ose koncepte përmes mjeteve artistike (pikturë, skulpturë, media digjitale etj.), duke theksuar procesin krijues dhe interpretimin personal.
- Format tjetër sipas natyrës së programit specifik.³

Pavarësisht nga lloji, punimi duhet të përmbushë kriteret e qartësisë shkencore, koherencës logjike, argumentimit të bazuar në burime kredibile dhe respektimit të etikës akademike.

Rekomandohet që punimi të ketë karakter empirik, në mënyrë që studenti të demonstrojë aftësi konkrete hulumtuese, duke përfshirë identifikimin e problemit, pyetjes kërkimore, përzgjedhjen e metodologjisë, mbledhjen dhe analizën e të dhënave, si dhe interpretimin e rezultateve.

³ Njësitë akademike sipas natyrës së programeve specifike mund të dizajnojnë udhëzues të veçantë për temën e diplomës.

Procedura e miratimit të temës

Studenti mund të nisë procedurën për temën e diplomës vetëm pasi të ketë fituar të drejtën për vitin e fundit të studimeve.

Në konsultim dhe marrëveshje paraprake me mentorin potencial, studenti propozon temën e punimit dhe paraqet kërkesën për miratim në zyrën e shërbimit studentor. Departamenti përkatës shqyrton propozimin dhe mund ta:

- miratojë temën;
- kërkojë riformulim apo saktësim të saj;
- propozojë ndryshime për të siguruar përputhshmëri me fushën e studimit dhe standardet akademike.

Tema duhet të jetë qartësisht e ndërlidhur me fushën përkatëse të programit Baçelor dhe të kontribuojë në trajtimin e një çështjeje relevante teorike ose praktike brenda asaj fushe.

Këshilli i departamentit ka të drejtë të propozojë ndryshimin e mentorit, nëse vlerësohet se tema është më e përshtatshme për një ekspert të një fushe tjetër brenda njësisë akademike, me qëllim të garantimit të cilësisë shkencore të punimit.

Pas miratimit zyrtar të temës, studenti vazhdon punën nën mbikëqyrjen e mentorit dhe, pas përfundimit të punimit, paraqet kërkesën për mbrojtje sipas procedurave të përcaktuara nga njësia akademike.

Realizimi i punimit të diplomës

Punimi i diplomës është punë individuale dhe realizohet nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e mentorit. Studenti është përgjegjës për organizimin, realizimin dhe përmbajtjen e punimit.

Një punim empirik duhet të përfshijë këto elemente themelore:

- shqyrtimin sistematik të literaturës relevante;
- identifikimin dhe formulimin e qartë të pyetjes kërkimore, problemit të studimit;
- përcaktimin e qëllimit dhe objektivave të hulumtimit;

- formulimin e pyetjes/pyetjeve kërkimore dhe/ose hipotezave (kur është e aplikueshme);
- përshkrimin e metodologjisë së përdorur (dizajni i hulumtimit, mostra, instrumentet, procedurat);
- mbledhjen, analizën dhe interpretimin e të dhënave;
- nxjerrjen e përfundimeve dhe, sipas rastit, rekomandimeve.

Një punim teorik duhet të përfshijë analizë të thelluar kritike, krahasim të qasjeve të ndryshme teorike, diskutim të argumentuar dhe konkluzione të mbështetura në literaturë bashkëkohore dhe relevante.

Shqyrtimi i literaturës duhet të mbështetet në burime shkencore kredibile (libra universitarë, artikuj në revista shkencore, publikime akademike). Rekomandohet që punimi të përfshijë jo më pak se 30 referenca kredibile dhe relevante shkencore. Burimet elektronike mund të përdoren, por duhet të jenë nga platforma dhe institucione të besueshme akademike ose shkencore. Të gjitha burimet duhet të citohen dhe referencohen sipas stilit të përcaktuar nga programi përkatës (p.sh., APA, Chicago, Harvard, etj.).

Respektimi i etikës akademike është i detyrueshëm. Çdo formë e plagjiaturës, paraqitjes së pavërtetë të të dhënave apo shkeljes së rregullave të citimit përbën shkelje serioze disiplinore dhe trajtohet sipas rregulloreve në fuqi të universitetit.

Punimi përgatitet në përputhje me këtë udhëzues zyrtar të universitetit për strukturën dhe formatin, si dhe duhet të përmbajë deklaratën e origjinalitetit dhe deklarinimin për përdorimin e veglave të bazuara në inteligjencën artificiale.

Pas përfundimit, punimi dorëzohet në tri kopje fizike të protokolluara dhe në një version elektronik të standardizuar, jo më vonë se shtatë ditë para datës së caktuar për mbrojtjen publike.

Mbrojtja publike e temës së diplomës

Mbrojtja publike e temës së diplomës realizohet vetëm pasi studenti të ketë përfunduar me sukses të gjitha provimet dhe obligimet e parapara në programin studimor. Plotësimin e kushteve akademike dhe administrative e verifikon shërbimi i studentëve, i cili konfirmon gatishmërinë e kandidatit për mbrojtje. Data e mbrojtjes caktohet jo më herët se pesë ditë kalendrike pas përfundimit të provimit

të fundit, ndërsa periudha nga aprovimi i temës deri në mbrojtjen publike duhet të jetë së paku një muaj dhe jo më shumë se një vit.

Në raste të arsyetuara, studenti mund të kërkojë shtyrjen e afatit të mbrojtjes vetëm një herë, duke paraqitur dëshmi përkatëse dhe pëlqimin me shkrim të mentorit. Mbrojtja zhvillohet në mënyrë publike para komisionit të emëruar, i cili vlerëson punimin dhe plotëson raportin përfundimtar të vlerësimit. Pas përfundimit të procedurës, mentori e regjistron notën në sistemin elektronik të universitetit.

Nëse kandidati nuk arrin ta mbrojë me sukses punimin e diplomës, ai/ajo ka të drejtë të riorganizojë mbrojtjen publike brenda tre muajve dhe kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm një herë. Nota e fituar në provimin e diplomës përfshihet në mesataren përfundimtare të studimeve dhe ndikon në suksesin e përgjithshëm akademik të studentit.

Titulli akademik dhe dokumentacioni

Pas përfundimit me sukses të studimeve themelore dhe mbrojtjes së temës së diplomës, studenti fiton titullin akademik përkatës, „Baçelor i Shkencës” ose „Baçelor i Arteve”, në varësi të programit të akredituar që ka ndjekur. Deri në momentin e pajisjes me diplomën zyrtare, njësia akademike ia lëshon studentit certifikatën e diplomimit, e cila shërben si dëshmi e përkohshme e përfundimit të studimeve.

Me rastin e marrjes së diplomës, studenti pajiset edhe me shtojcën e diplomës (‘Diploma Supplement’), dokument që përmban informacion të detajuar mbi programin e studimeve, rezultatet e arritura dhe nivelin e kualifikimit, duke lehtësuar njohjen akademike dhe profesionale në kontekst vendor dhe ndërkombëtar.

Listë kontrolli për studentin

- Kam mentor të konfirmuar
- Kam dorëzuar kërkesën zyrtare
- Kam respektuar udhëzuesin e shkrimit
- Kam dorëzuar 3 kopje + version elektronik
- Kam përfunduar të gjitha provimet
- Jam gati për mbrojtje publike

VLERËSIMI DHE PËRSHKRIMI I NOTAVE

Përshkrimet më poshtë duhet të përdoren si pika referuese për notimin e përgjithshëm në format e vlerësimit të temës së diplomës. Në notën përfundimtare të merret parasysh edhe nota mesatare gjatë studimeve, sipas rregullores së studimeve themelore.

5 (pamjaftueshëm). Studimi ka shkelur parimet themelore etike. Tema e studiuar nuk është relevante dhe sfondi teorik nuk është i lidhur me problemin që po studiohet. Studimi nuk përdor të dhëna të mjaftueshme për studimin dhe prezantimi i gjetjeve nuk lidhet me pyetjet kërkimore dhe problemin që po studiohet. Gjuha nuk është e pranueshme për shkrim akademik.

6 (mjaftueshëm). Studimi i plotëson kërkesat minimale për temën e diplomës sipas programit përkatës. Sfondi i studimit është ose shumë i ngushtë ose shumë i gjerë. Qëllimi i studimit është diskutuar, në njëfarë mase, në pjesën e hyrjes. Megjithatë, lidhjet me teorinë dhe kërkimet e mëparshme, nuk janë shtjelluar. Teoritë dhe studimet e përmbledhura janë të lidhura dobët me pyetjen kërkimore, problemin e hulumtimit. Përdorimi i metodave të hulumtimit është i pamjaftueshëm ose jokonsistent. Prezantimi i rezultateve është sipërfaqësor apo në formë liste dhe ka mangësi dhe mospërputhje në rezultate apo përfundime. Diskutimi është i mangët dhe nuk arrin një nivel më të përgjithshëm të interpretimit. Gjuha është mjaft e varfër.

7 (kënaqshëm). Tema është e zakonshme, arsyetimet mbi të dhe fokusimi janë të pamjaftueshme. Teoritë përkatëse dhe rezultatet e hulumtimit janë prezantuar në formë të listës dhe në mënyrë mekanike, sfondi i paraqitur si tërësi është shumë i gjerë apo shumë i ngushtë. Autori është përpjekur të lidhë pikat fillestare të studimit, si dhe qëllimin dhe problemin e hulumtimit me njohuritë e mëparshme, por pa demonstruar sukses domethënës. Disa nga elementet e qëllimit të hulumtimit janë dobët të lidhura me sfondin teorik, ose nuk merren parasysh në lidhje me rezultatet. Metodot e hulumtimit kanë mangësi si dhe rezultatet janë paraqitur në formë të njëtrajtshme. Lidhja me kontekstin teorik mbetet modeste. Interpretimi i rezultateve tregon një lidhje të pikënisjes së studimit dhe me rezultatet e mëhershme.

8 (mirë). Rëndësia e temës së zgjedhur është deklaruar dhe arsyetuar. Sfondi teorik i studimit është prezantuar në tërësi dhe kjo tregon njohuri të mira për hulumtimet e mëparshme. Literatura e zgjedhur

është relevante për problemet e hulumtimit dhe literatura kredibile, p.sh. edhe ajo e huaj, është përdorur si një pjesë thelbësore e studimit. Sfondi teorik i tezës apo baza praktike e fenomenit është shtjelluar dhe lidhja me problemin hulumtues është demonstruar, edhe pse jo në detaje. Zgjedhja e metodës së hulumtimit është justifikuar në një mënyrë që tregon njohuri të metodave të hulumtimit. Metodatat e zgjedhura janë aplikuar në mënyrë konvencionale, kryesisht korrekte. Interpretimi i rezultateve është i një niveli të lartë, siç janë edhe përfundimet dhe ka pasur një përpjekje për të arritur një dialog midis teorisë dhe gjetjeve empirike.

9 (shumë mirë). Teza trajton një temë të re, relevante dhe të rëndësishme, problemet e së cilës janë paraqitur dhe zhvilluar në mënyrë të pavarur. Sfondi teorik dhe pikat nismëtare të studimit demonstrojnë njohje të mirë të teorisë. Pyetja kërkimore, problemi i hulumtimit është përshkruar saktësisht, është arsyetuar mjaftueshëm dhe është bërë lidhje e mirë me sfondin teorik. Literatura kredibile dhe relevante, p.sh. ajo vendore dhe ndërkombëtare, është përdorur në funksion të shtjellitimit të pyetjes, problemit kërkimorë. Zgjedhja e metodës së hulumtimit dhe arsyetimet për këtë demonstrojnë njohuri metodologjike. Grumbullimi i të dhënave dhe metodatat e analizave janë përdorur me shumë aftësi dhe vlefshmëria e tyre për qëllimin e hulumtimit është vlerësuar dhe demonstruar. Metoda e zgjedhur për analizë është në harmoni me qëllimin dhe të dhënat e hulumtimit. Interpretimi i rezultateve dhe konkludimeve është logjik, i justifikuar dhe i kontribuon hulumtimit si tërësi. Gjuha dhe struktura e tezës janë koherente dhe të një niveli të lartë.

10 (shkëlqyeshëm). Tema e diplomës demonstroi qartë se është e rëndësishme, relevante dhe mbi një temë mesatare. Tema tregon familjaritet të thellë të autorit me teori të rëndësishme, probleme metodologjike dhe praktika shkencore, përveç zotërimit të shkëlqyer të punës hulumtuese dhe raportimit. Të menduarit e pavarur është i dukshëm në disa nënfusha të procesit të hulumtimit, veçanërisht në fushat e kriterëve të vlerësimit si në vijim:

- a) ristrukturimi dhe sintetizimi i teorisë dhe hulumtimeve të mëparshme, në një mënyrë që prodhon perspektiva të reja;
- b) freski, rëndësi dhe inovacion të temës dhe qëllimit të hulumtimit;
- c) e fokusuar në qëllim, pikënisje dhe probleme të hulumtimit;
- d) zgjedhja, zhvillimi, vlerësimi dhe zbatimi i mbledhjes së të dhënave dhe/ose metodave të analizës;
- e) interpretimi i rezultateve, përfundimeve dhe diskutimit.

INTEGRITETI AKADEMIK, ETIKA HULUMTUESE DHE PËRDORIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

Plagjiatura përbën një shkelje serioze të integritetit akademik dhe konsiderohet formë e mashtrimit akademik. Të gjithë studentët duhet ta kuptojnë qartë përmbajtjen e këtij nocioni dhe të shmangin çdo praktikë që cenon origjinalitetin e punës së tyre gjatë studimeve. Plagjiaturë konsiderohet përdorimi i ideve, teksteve, të dhënave ose krijimeve të autorëve të tjerë pa citim dhe referencim adekuat, duke i paraqitur ato si kontribut personal. Në komunitetin akademik, veprime të tilla trajtohen me seriozitet të lartë dhe mund të sjellin pasoja disiplinore. Për këtë arsye, studentët dhe mësuesit duhet të sigurojnë referencimin korrekt të çdo burimi të përdorur, në përputhje me teknikat dhe standardet shkencore të citimit.

Gjatë realizimit të punës hulumtuese, një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet etikës profesionale dhe përgjegjësisë akademike. Hulumtimet zhvillohen në kontekste reale shoqërore dhe natyrore, prandaj kërkohet respektimi i standardeve etike në të gjitha fazat e procesit. Studentët duhet të marrin parasysh ndjeshmërinë e mbledhjes së të dhënave personale, të respektojnë privatësinë dhe dinjitetin e pjesëmarrësve dhe të veprojnë në përputhje me normat ligjore dhe institucionale. Mosrespektimi i këtyre parimeve mund të krijojë pengesa serioze gjatë zhvillimit të hulumtimit dhe të ndikojë në vlefshmërinë e rezultateve.

Parimet themelore të etikës hulumtuese përfshijnë respektimin e dinjitetit njerëzor, duke trajtuar çdo individ me drejtësi dhe duke mbrojtur të drejtat e njeriut; parimin e dobisë, që nënkupton zhvillimin e hulumtimeve me synim përmirësimin e praktikave dhe shmangien e çdo forme dëmtimi apo shfrytëzimi të pjesëmarrësve; si dhe parimin e korrektësisë, që lidhet me paanshmërinë, respektimin e autorësisë, qasjen e barabartë dhe mbështetjen e grupeve me nevoja të veçanta.

Në përputhje me udhëzimet institucionale për përdorimin e inteligjencës artificiale, studentët mund të përdorin vegla të bazuara në IA vetëm si mjete mbështetëse për kërkim, organizim të ideve ose përmirësim gjuhësor, duke ruajtur gjithmonë përgjegjësinë personale për përmbajtjen akademike. Përdorimi i IA-së duhet të jetë transparent dhe i deklaruar në punim, ndërsa *gjenerimi automatik i përmbajtjes* që zëvendëson kontributin origjinal të studentit *nuk lejohet*. Çdo informacion i marrë përmes

IA-së duhet të verifikohet në mënyrë kritike dhe të citohet në mënyrë të përshtatshme, duke respektuar standardet e integritetit akademik.


Gjatë punës hulumtuese, studentët duhet të demonstrojnë integritet akademik, duke njohur kontributet e burimeve të tjera, duke përfunduar punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe duke ndjekur udhëzimet metodologjike të disiplinës përkatëse. Para fillimit të mbledhjes së të dhënave, rekomandohet sigurimi i pëlqimit të informuar dhe nënshkrimi i deklaratave etike nga pjesëmarrësit, në përputhje me praktikat e miratuara institucionale.

Në rast se një punim diplome konstatohet se përmban plagjiaturë ose shkelje të rënda të integritetit akademik, përfshirë përdorimin e papranueshëm të inteligjencës artificiale, këshilli i fakultetit ndërmerr masa adekuate në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi të Universitetit të Prishtinës.

KOPERTINA E PUNIMIT (NJËSOJ ME FAQEN E TITULLIT TË TEZËS)

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI _____

PROGRAMI: [VENDOSËT PROGRAMI I STUDIMEVE]



PUNIM DIPLOME

[Titulli i punimit vetëm me shkronjë të parë të madhe]

Mentori/ja:

Prof. Emri dhe mbiemri

[nëse mentori nuk është profesor i/e rregullt = Prof. Asoc. Dr. apo Prof. Asst. Dr.]

Kandidati/ja:

Emri i kandidatit/tes


Prishtinë, muaji, viti

Qëllimisht e lënë e bardhë

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI _____

PROGRAMI: [VENDOSËT PROGRAMI I STUDIMEVE]



PUNIM DIPLOME

[Titulli i punimit vetëm me shkronjë të parë të madhe]

Mentori/ja:

Prof. Emri dhe mbiemri

[nëse mentori nuk është profesor i/e rregullt = Prof. Asoc. Dr. apo Prof. Asst. Dr.]

Kandidati/ja:

Emri i kandidatit/tes

Prishtinë, muaji, viti

Qëllimisht e lënë e bardhë

© [viti]-[emri i autorit] Të gjitha të drejtat të rezervuara.

DEKLARATË E ORIGINALITETIT DHE PËRDORIMIT TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

Unë, i/e nënshkruari/a _____, deklaroj se punimi i diplomës me titull:

» _____»

është rezultat i punës sime origjinale dhe është realizuar në përputhje me parimet e integritetit akademik dhe etikës hulumtuese. Të gjitha burimet e përdorura gjatë hartimit të këtij punimi janë cituar dhe referuar në mënyrë të plotë dhe të rregullt sipas standardeve akademike në fuqi.

Deklaroj se ky punim nuk është paraqitur më parë për vlerësim në ndonjë institucion tjetër arsimor dhe nuk përmban materiale të marra nga autorë të tjerë pa citim adekuat.

Në lidhje me përdorimin e veglave të bazuara në inteligjencën artificiale, deklaroj se:

Nuk janë përdorur vegla të inteligjencës artificiale gjatë hartimit të këtij punimi.

ose

Janë përdorur vegla të inteligjencës artificiale vetëm si mbështetje teknike (p.sh., për korrektim gjuhësor, strukturim të ideve ose sugjerime stilistike), ndërsa analiza, interpretimi dhe përmbajtja shkencore janë rezultat i punës sime personale. Përdorimi i tyre është bërë në mënyrë transparente dhe në përputhje me udhëzimet institucionale.

Jam i/e vetëdijshtëm/e se çdo shkelje e integritetit akademik, përfshirë plagjiaturën ose përdorimin e papranueshëm të inteligjencës artificiale, mund të sjellë masa disiplinore sipas rregulloreve të Universitetit të Prishtinës.

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Përmbajtja

[të paraqet çdo pjesë që ngërthen punimi pa përjashtim si dhe numrin e faqeve gjegjëse]

.....

.....

.....

Hapsirë e thjeshtë
mes rreshtas 1.0

Hapsirë mes
rreshtash në tërë
tekstin 1,5

ABSTRAKTI

Në parim, abstrakti nuk duhet t'i tejkalojë **350** fjalë. Sidoqoftë, abstrakti së bashku me fjalët kyçe assesi nuk duhet të jetë më i gjatë dhe më i shtrirë se një faqe.

Tema tashmë e studiuar paraqitet përmes një abstrakti: me linjën teorike, e cila e mbështet punimin.

Qëllimin dhe rëndësia e studimit.

Po ashtu duhet të përmendet metodologjia e vënë në praktikë (sasiore, cilësore, e përzier), detaje rreth mostrës, si dhe rezultatet e dala nga studimi dhe një sqarim i shkurtër i konkluzioneve të arritura.

Fjalët kyçe: *terme që përfaqësojnë punimin, duhet vënë ndërmjet tri apo 5 fjalë kyçe të renditura sipas alfabetit.*

Hyrje

Në hyrje bëhet një paraqitje e hollësishme e rëndësisë së problemit, që paraqet thelbin e hulumtimit dhe shpjegohen arsyet, që e kanë nxitur kandidatin/en për zgjedhjen e temës dhe të problemit të caktuar.

Në hyrje, paragrafi/et e fundit, studenti duhet, përveç motiveve dhe rëndësisë që përmend për hulumtimin apo studimin në pyetje, **të ofroj një pasqyrë, përshkruajë shkurtimisht përmbajtjen dhe strukturën e temës, në mënyrë që lexuesi të informohet në tërësi për punimin.**

Shqyrtimi i literaturës

Në këtë pjesë kandidati bën një përshkrim të përgjithshëm të „fushës së studimit” dhe e vendos temën e studiuar në kuadër të saj. Këtu është e domosdoshme të paraqiten, krahasohen dhe vlerësohen teoritë më të rëndësishme, që lidhen me temën e propozuar. Rekomandohet të bëhet një përshkrim i përgjithshëm dhe i shtjelluar hollësisht i hulumtimeve përkatëse (libra, artikuj, raporte hulumtuese), që janë bërë prej autorëve të tjerë (vendorë dhe ndërkombëtarë), me përqendrim në gjetjet dhe përfundimet e tyre. Hulumtimet e kohëve të fundit (p.sh. të botuara gjatë këtij dhjetëvjeçari) duhet të vendosen në radhë të parë. Kandidati/ja duhet ta bëjë të qartë se çfarë dihet në fushën përkatëse (në lidhje me temën apo problemin që ka shtjelluar) dhe se çka nuk është trajtuar ende në mënyrë sistematike, apo cilat pyetje kanë mbetur pa përgjigje.

Një prej kërkesave kryesore të kësaj pjesë është një *përshkrim i perspektivës teorike*. Në punën kërkimore gjithnjë fillohet prej të kuptuarit teorik, që e mbizotëron fushën e caktuar. Paradigmat dhe konceptet teorike të autorëve/shkencëtarëve të njohur, jo vetëm që ndikojnë në hulumtimin (e ardhshëm), por ato **shërbejnë si fillesa të një studimi në lidhje me një ‘fushë’ të caktuar.**

Si rrjedhojë, kandidati/ja duhet të vendosë se në cilën „rrymë teorike” mbështet apo përcjell punimi, përmes paradigmeve dhe koncepteve teorike, që janë të përafërta me problemin, që e ka parashtruar dhe që e mbështesin më së miri hulumtimin e tij/saj. Për të qenë më konkret: ky kapitull duhet të përfshijë një analizë të literaturës së përzgjedhur, për shembull, një paraqitje të ngjeshur të teorive/autorëve kryesorë dhe të monografive më të rëndësishme shkencore në lëmin e caktuar. Po

ashtu, duhet të bëhet e qartë se pse këto teori janë të rëndësishme dhe të dobishme për hulumtimin e planifikuar.

Udhëzimet APA për CITIMIN në TEKST dhe se si duhen referuar, mund t'i shohim në vijim, pra citimet mund të jenë parafrazime ose citim i drejtpërdrejtë i një burimi nga puna e ndonjë autori tjetër. Citimet zakonisht bëhen me emërtimet e autorëve, mbiemri i autorit dhe viti i publikimit dhe vetëm kur citohet literalisht dhe drejtpërdrejt, atëherë vihet numri i faqes/faqeve. Shembujt e mëposhtëm të huazuar nga botimi i gjashtë i APA (APA, 2010).

Citimi indirekt përmes citimit me kllapa, historikisht libraritë vlerësojnë lart lirinë intelektuale dhe sjelljen e konfidencialitetit (LaRue, 2007).

Mirëpo, nëse **citimi indirekt** bëhet me **autorin si pjesë të tregimit**, atëherë mund të themi LaRue (2007) identifikoi lirinë intelektuale dhe sjelljen e konfidencialitetit si dy vlera kyçe, të cilat janë mbajtur historikisht nga libraritë.

Citim i drejtpërdrejtë me kllapa: Darwini përdori metaforën e lisit jetësor „për të shprehur një formë tjetër të ndërlidhshmërisë gjenealogjike e jo ekologjike” (Gould & Brown, 1991, f. 14).

Citim i drejtpërdrejtë me autorin si pjesë e tregimit: Gould dhe Brown (1991) shpjeguan se Darwini përdori metaforën e lisit jetësor „për të shprehur një formë tjetër të ndërlidhshmërisë gjenealogjike e jo ekologjike” (f. 14).

Brenda tekstit mund edhe të citojmë **burime dytësore**. Janë ato burime, të cilat ne i citojmë nga një punim tjetër tërthorazi, të cilin e lexojmë dhe hasim në një citim që mund të na interesojë. Pra, në këto raste duhet të përmenden të dyja burimet, edhe i pari edhe dytësi. Në shembullin në vijim, studimi i Seidenberg dhe McClelland është përmendur në artikullin e Coltheart, Curtis, Atkins, & Haller. Pra citohet si: studimi i Seidenberg dhe McClelland-it (siç citohet në Coltheart, Curtis, Atkins, & Haller, 1993) i paraqiti botës një vizion të shkurtër të procesimit të fjalëve. Pastaj në fund, në faqen e referencave bibliografike, duhet të citohet burimi dytësor, i cili është lexuar nga ju, e jo ai studimi origjinal, shih shembullin në vijim.

Coltheart, M., Curtis, B., Atkins, P., & Haller, M. (1993). Models of reading aloud: Dual-route and parallel-distributed processing approaches. *Psychological Review*, 100, 589-608.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit përshkruan synimin kryesor të studimit dhe tregon çfarë dëshiron studenti të analizojë, vlerësojë ose eksplorojë. Ai duhet të jetë i qartë, realist dhe në përputhje me fushën e studimit. Studentët rekomandohen të përdorin folje veprimi si: të analizojë, të vlerësojë, të identifikojë ose të krahasojë.

Shembull: „Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë ndikimin e strategjive të menaxhimit të klasës në përqendrimin e nxënësve të klasave fillore.”

Pyetja hulumtuese dhe hipotezat

Pyetja/et hulumtuese udhëheqin studimin dhe duhet të jenë specifike dhe të matshme. Në studimet kuantitative mund të formulohen edhe hipoteza të testueshme.

Shembull i një pyetje hulumtuese:

- Si ndikojnë strategjitë vizuale në përqendrimin e nxënësve?

Shembull hipoteze:

- Përdorimi i strategjive aktive të të nxënit rrit nivelin e përqendrimin të nxënësve.

Mostra e hulumtimit

Në këtë pjesë studenti duhet të përshkruajë pjesëmarrësit, numrin e tyre, karakteristikat demografike dhe mënyrën e përzgjedhjes së mostrës (p.sh., mostrim qëllimor ose rastësor).

Shembull:

- Mostra përbëhet nga 60 nxënës të klasës së tretë në dy shkolla fillore publike, të përzgjedhur përmes mostrimit të qëllimshëm.

Instrumentet e hulumtimit

Instrumentet janë mjetet për mbledhjen e të dhënave, si pyetësorë, intervista, fletë vëzhgimi ose teste vlerësimi. Studenti duhet të përshkruajë qartë se çfarë mat secili instrument dhe si është ndërtuar.

Shembull:

- Për mbledhjen e të dhënave u përdor një pyetësor me 15 pyetje Likert për të matur nivelin e motivimit të nxënësve.

Të shpjgohet nëse janë materiale tashmë të njohura, nëse janë huazuar dhe kanë treguar efikasitetin e tyre paraprakisht, apo janë zhvilluar nga autori. Nëse janë zhvilluar, duhet të elaborohen konstruktet kryesore, natyra e të dhënave që synohet të mblidhen. Kjo bëhet për secilin instrument ndaras. Mund të jepen të plota instrumentet në shtojca dhe referenca e tillë identifikohet në këtë pjesë.

Procedura

Shpjgohet saktësisht se si ka qenë renditja e ndodhive, prej ndërtimit të instrumenteve, deri te identifikimi i pjesëmarrësve dhe mbledhja e të dhënave përmes instrumenteve të ndryshme.

Konsideratat etike

Çdo temë diplome duhet të respektojë parimet e etikës hulumtuese dhe integritetit akademik. Studentët duhet të sigurojnë pëlqimin e informuar të pjesëmarrësve, konfidencialitetin e të dhënave dhe trajtim të drejtë dhe të paanshëm të individëve.

Parimet kryesore etike përfshijnë:

- Respektimin e dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të pjesëmarrësve;
- Konfidencialitetin dhe anonimizimin e të dhënave;
- Raportimin e paanshëm dhe të saktë të rezultateve.

Përdorimi i inteligjencës artificiale lejohet vetëm si mjet mbështetës dhe duhet të deklarohet në mënyrë transparente. Përmbajtja analitike dhe interpretimi duhet të jenë rezultat i punës origjinale të studentit.

Shembull formulimi etik:

„Ky hulumtim është zhvilluar në përputhje me parimet e etikës hulumtuese. Pjesëmarrësit kanë dhënë pëlqimin e informuar dhe të dhënat janë anonimizuar. Veglat e inteligjencës artificiale janë përdorur vetëm për mbështetje gjuhësore dhe janë deklaruar në punim.”

Analiza e të dhënave dhe rezultatet

Në këtë seksion, duhet të shpjegohet mënyra dhe/apo programi, që është përdorur për analizë të të dhënave. Nëse të dhënat janë sasiore (kuantitative), mund të bëhen analiza të ndryshme, si për shembull, analiza e të dhënave u realizua përmes programit Exel ose SPSS, përmes një analize të krahasimit të mesatareve të pikëve në testet e matematikës të djemve dhe vajzave.

Ndryshorja, variabla, e varur në këtë rast janë pikët e testeve të matematikës ndërsa ndryshorja, variabla, e pavarur është gjinia. Këto analiza duhet të paraqiten me grafikë ose tabela, si p.sh.:

Grafiku nr. ...




Tabela nr. ...

Statistikat përshkruese për nivelin e motivimit të nxënësve

<i>Variabli</i>	<i>N</i>	<i>Mesatarja (M)</i>	<i>Devijimi Standard (SD)</i>
Motivimi akademik	60	3.85	0.72
Angazhimi në klasë	60	4.10	0.65
Përqendrimi	60	3.60	0.80

Shënim: M = Mesatarja; SD = Devijimi standard. Tabela është paraqitur sipas formatit bazë APA. Një çështje shumë më rëndësi, brenda seksionit të analizës së të dhënave dhe të rezultateve, është qartësimi i faktit, se nuk është e nevojshme të paraqiten të gjitha rezultatet nga të dhënat në tabela dhe figura, e madje shpesh hasim në të dyja versionet për të dhënat e njëjta.

Studenti duhet të jetë në gjendje të nxjerrë nga të dhënat e tij, vetëm rezultatet më përfaqësuese të studimit dhe t'i bëjë të dukshme për lexuesin në formën që konsideron më të mirë, tabelë apo figurë dhe pastaj të shpjegojë se çfarë përfaqësojnë ato të dhëna/rezultate shumë shkurtimisht. Sipas nevojës, rezultatet më të detajuara mund të vendosen në shtojcat përkatëse. Është me rëndësi që, gjatë paraqitjes së rezultateve, të kthehemi tek qëllimi dhe tek pyetjet kërkimore për të bërë lidhjen logjike me to.

Konkludimet

Seksioni i konkludimeve përmbledh gjetjet kryesore të hulumtimit në mënyrë sintetike dhe analitike, duke iu referuar drejtpërdrejt qëllimit të studimit dhe pyetjeve hulumtuese. Studentët duhet të shmangin përsëritjen e rezultateve në formë deskriptive dhe të fokusohen në interpretimin e tyre.

Konkludimet duhet të tregojnë se çfarë kuptimi kanë rezultatet për praktikën arsimore ose fushën përkatëse dhe si lidhen ato me literaturën ekzistuese.

Rekomandimet duhet të jenë konkrete, të realizueshme dhe të bazuara në gjetjet e studimit. Ato mund të adresohen për mësimdhënësit, institucionet arsimore, politikëbërësit ose hulumtimet e ardhshme.

Shembull formulimi:

„Bazuar në rezultatet e studimit, rekomandohet që mësimdhënësit të integrojnë strategji aktive të të nxëniet për të rritur angazhimin e nxënësve, ndërsa studimet e ardhshme mund të analizojnë ndikimin afatgjatë të këtyre strategjive në performancën akademike.”

Referencat bibliografike

Gjithmonë referencat vihen në një faqe të re.

Hapësira mes rreshtash – Duhet të jetë 1.5.

Vendosja e referencave – Rreshti i parë i çdo reference të re, duhet të jetë me një margjinë 0,5 majtas. Të gjithë rreshtat tjerë, duhet të jenë të nxjerrë në kryeradhë (indent) pesë hapësira të bardha ose me një tab. të vendosur në 0,5 inch djathtas.

Radhitja e referencave – sipas rendit alfabetik të mbiemrit të autorit të parë dhe nëse ka më shumë se një reference për një autor, atëherë kjo bëhet në bazë të viteve të publikimit, duke filluar nga botimi më i ri deri te më i vjetri. Në qoftë se një autor ka më shumë se një publikim në të njëjtin vit atëherë, pranë vitit të publikimit vendoset shkronja a ose b, brenda kllapave.

Referencat dhe citimet duhet të bëhen sipas standardit të APA-së (American Psychological Association). Në referenca bibliografike futen vetëm burimet që janë cituar diku në tekst dhe jo materialet që janë shfrytëzuar për lexim të përgjithshëm. Ja disa shembuj të huazuar nga botimi i 6^{te} i APA-së për format e citimit.

REFERENCA PËR LIBËR

(mbiemri dhe emri i autorit, viti i botimit, titulli i librit, vendi i botimit dhe botuesi):

Një autor

Alexie, S. (1992). *The business of fancydancing: Stories and poems*. Brooklyn, NY: Hang Loose Pres

Autorësi e përbashkët dhe i publikuar nga një botues

Association. (1994). *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (4th ed.). Washington, DC: Author.

Autor anonim

Dorland's illustrated medical dictionary (31st ed.). (2007). Philadelphia, PA: Saunders.

Kapitull libri

Booth-LaForce, C., & Kerns, K. A. (2009). Child-parent attachment relationships, peer relationships, and peer-group functioning. In K. H. Rubin, E. M. Bukoëski, & B. Laursen (Eds.), *Handbook of peer interactions, relationships, and groups* (pp. 490-507). New York, NY: Guilford Press.

Dokument nga ERIC

Shyyan, V., Thurlow, M., & Liu, K. (2005). *Student perceptions of instructional strategies: Voices of English language learners with disabilities*. Minneapolis, MN: National Center on Educational Outcomes, University of Minnesota. Retrieved from the ERIC database. (ED495903)

Referenca për revista shkencore dhe gazeta në versionin e printuar

Një autor

Williams, J. H. (2008). Employee engagement: Improving participation in safety. *Professional Safety*, 53(12), 40-45.

Nga dy deri në shtatë autorë [rendit të gjithë autorët] / grup autorësh

Keller, T. E., Cusick, G. R., & Courtney, M. E. (2007). Approaching the transition to adulthood: Distinctive profiles of adolescents aging out of the child welfare system. *Social Services Review, 81*, 453-484.

Tetë apo më shumë autorë [rendit gjashtë autorët e parë, ... dhe autorin e fundit] / grup autorësh

Wolchik, S. A., West, S. G., Sandler, I. N., Tein, J.-Y., Coatsworth, D., Lengua, L., ... Griffin, W. A. (2000). An experimental evaluation of theory-based mother and mother-child programs for children of divorce. *Journal of Consulting and Clinical Psychology, 68*, 843-856.

Revistë javore

Mathews, J., Berrett, D., & Brillman, D. (2005, May 16). Other winning equations. *Newsweek, 145*(20), 58-59.

Artikull i gazetarisë pa autorë dhe renditje të çrregullt

Generic Prozac debuts. (2001, August 3). *The Washington Post*, pp. E1, E4.

Artikuj të marrë nga burime online

Senior, B., & Swales, S. (2007). Inside management teams: Developing a teamwork survey instrument. *British Journal of Management, 18*, 138-153. doi:10.1111/j.1467-5512.2006.00507.x

Artikull nga një revistë online

Lodewijckx, H. F. M. (2001, May 23). Individual-group continuity in cooperation and competition under varying communication conditions. *Current Issues in Social Psychology*, 6(12), 166-182. Nxjerrë nga <http://www.uiowa.edu/~grpproc/crisp/crisp.6.12.htm> dhe data se kur është marrë (26.07.2015)

Raporte online nga organizata joqeveritare

Kenney, G. M., Cook, A., & Pelletier, J. (2009). *Prospects for reducing uninsured rates among children: How much can premium assistance programs help?* Marrë nga: Urban Institute website: Marrë nga: www.urban.org/url.cfm?ID=411823

Raporte online pa autorë të identifikuar apo edhe pa datë

GVU's 10th www user survey. (n.d.). Marrë nga: https://sites.cc.gatech.edu/gvu/user_surveys/survey-1998-10/

Web Site/ Ueb faqe me citim në kllapa

Për ta cituar një ueb faqe të tërën (dhe jo një dokument të veçantë brenda saj), mjafton të vendosim URL-në e uebit në tekst.

Referencat biobibliografike

APA (2009) Publication Manual of the American Psychological Association, 6th ed. *American Psychological Association*. Washington, DC.

LaRue, J. (2007). *The new inquisition: Understanding and managing intellectual freedom challenges*. Libraries Unlimited.

Shtojca/t: Titulli i shtojcës/shtojcave

Nëse keni vetëm një shtojcë, atëherë titulli nuk përmban ndonjë shkronjë, shkruhet vetëm Shtojcë dhe titulli.